



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Komisioni i Dhënies së Komisionit/PPP të Aeroportit të Kukësit

Lënda: Njoftim për ndryshime të Dokumentave Standarde si dhe për zgjatje të afatit kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave të procedurës konkurruese për dhënien me koncesionit/PPP të Aeroportit të Kukësit

Agjencisë së Prokurimit Publik

Blvd: “Dëshmorët e Kombit”, pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë

Në zbatim të nenit 24, pika 7, të Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, nenit 42 pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të VKM nr. 130 datë 12.3.2014 “Per kryerjen ne mënyrë elektronike te procedurave konkurruese te koncesionit/ partneritetit publik privat”, Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njofton gjithë operatorët ekonomike se bën këto ndryshime në Dokumentat e Koncesionit/PPP si vijon:

1. Tek Shtojca 9, në pikën 2.3. Kapaciteti Teknik tek tabela e Lista e makinerive të bëhen ndryshimet me përmbajtjen si vijon:
 - Ishte “Trailer (transportues) – cope 3, të dhënat - 30 ton”, bëhet “Trailer (transportues) – cope 3, të dhënat - mbi 20 ton”;
 - Ishte “Gjenerator – sasia 10, të dhënat - 5 kVA”, bëhet “Gjenerator – sasia 5, të dhënat - mbi 2 kVA”;
 - Ishte “Kamion vinc - sasia 8, të dhënat 1.5 ton”, bëhet “Kamion vinc - sasia 4, të dhënat - 1.5 ton”;
 - Ishte “Kamion vetëshkarkues - sasia 70, të dhënat - 20 m³”, bëhet “Kamion vetëshkarkues - sasia 45, të dhënat - 20 ton”;
 - Ishte “Buldozer - sasia 5, të dhënat – D6-D8”, bëhet “Buldozer - sasia 4, të dhënat – D4- D5-D6-D7-D8”;
 - Ishte “Rrul për mbushje rrugore”- sasia 10, te dhënat – minimum 12 ton, behet “Rrul për mbushje rrugore”- sasia 8, te dhënat- minimum 8 ton”;
 - Ishte “Autobot uji - sasia 8, të dhënat – 10 000 litra”, bëhet “Autobot uji – sasia 4, të dhënat – jo me pak se 2 000 litra”;
 - Ishte “Greider - sasia 5, të dhënat – 110 hp”, bëhet “Greider - sasia 3, te dhënat – hiqet 110 hp”;
 - Ishte “Kamioncine - sasia 9, të dhënat – Min. 1.5 ton”, bëhet “Kamioncine - sasia 5, të dhënat – Min. 1 ton”;
 - Ishte “Asfaltoshtruese - sasia 3, të dhënat – me gjerësi 12 m”, bëhet “Asfaltoshtruese - sasia 3, të dhënat – me gjerësi jo me < se 5 m”;
 - Ishte “Rrul asfalti - sasia 10, të dhënat – Min. 12 ton”, bëhet “Rrul asfalti - sasia 5, të dhënat – Min. 5 ton”;

- Ishte “Bitumatrice - sasia 2, të dhënat – Jo më pak se 8 000 litra”, bëhet “Bitumatrice - sasia 2, të dhënat – Jo më pak se 2 000 litra”;
 - Ishte “Makine vijëzimi termoplastike – sasia 1, të dhënat – Jo më pak se 5 ton, bëhet “Makine vijëzimi termoplastike – sasia 1, të dhënat - hiqet jo më pak se 5 ton”;
2. Tek Shtojca 9, në pikën 2.3. Kapaciteti Teknik tek pikat e Licencës profesionale të vlefshme për kategorinë e punëve të kontratës, të bëhen ndryshimet me përmbajtjen si vijon:
- Ishte “NP-2-F “Ndërtime civile dhe industriale” Behet “NP-2-D “Ndërtime civile dhe industriale”;
3. Tek seksioni “Udhëzime për Ofertuesit” te shtohet pika 1.7. me këtë përmbajtje:

“Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që para nënshkrimit të kontratës koncesionare/PPP të kryejë verifikimet pranë ALBCONTROL për të dhënat e fluturimeve në Aeroportin e Kukësit”

Si rrjedhojë, afati kohor për dorëzimin e ofertave:

Brenda dhe jo më vonë se: Data: **20/12/2018 Ora: 12:00 A.M.**

Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave:

Brenda dhe jo më vonë se: Data: **20/12/2018 Ora: 12:00 A.M.**

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri